




**Republika e Kosovës**  
*Republika Kosova - Republic of Kosovo*



**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

|                        |                                                                                                     |
|------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|
| DATE/A:                | 22.03.2018                                                                                          |
| REFERENC-Ë:            | AKK- DPKPP /03-03-897/18                                                                            |
| PËR/ZA/TO:             | z. Bekim DAKAJ,<br>Menaxher i Divizionit të Prokurimit në Akademinë e Kosovës<br>për Siguri Publike |
| CC:                    | z. Ismail SMAKIQL,<br>Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri<br>Publike           |
| NGA/OD/FROM:           | Shaip HAVOLLI,<br>Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit                                           |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me tenderin " <b>Projektimi dhe Mbikëqyrja e Objekteve në AKSP</b> "                 |

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. \_\_\_\_\_  
 Dep. DPK  
 Nr. i faq. \_\_\_\_\_  
 Nr. pages 03

Nr. Prot. \_\_\_\_\_  
 Br. Prot. 03-03/929/18  
 Prot No. \_\_\_\_\_  
 Data \_\_\_\_\_  
 Datum 22-03-2018

PRISHTINË

*I nderuar z. DAKAJ,*

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Projektimi dhe Mbikëqyrja e Objekteve në AKSP ", me numër të prokurimi: 214-18-1555-221, me nr. të brendshëm: 214-18-05-221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

## O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Projektimi dhe Mbikëqyrja e Objekteve në AKSP** ", me numër të prokurimi: 214-18-1555-221, me nr. të brendshëm: 214-18-05-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

## *A r s y e t i m i*

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 21.03.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-897/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "**Projektimi dhe Mbikëqyrja e Objekteve në AKSP**", me numër të prokurimit: *214-18-1555-221*, me nr. të brendshëm: *214-18-05-221*, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Akademia e Kosovës për Siguri Publike.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi** ka analizuar Njoftimin për Kontratë, Dosjen e Tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku tek pjesa e kriterëve për dhënie të kontratës, Agjencia ka vërejtur se Autoriteti kontraktues si kriter për dhënie të kontratës ka caktuar kriterin **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm**, ndërsa si nën kriterë ka caktuar: **1. Çmimin të cilit i ka caktuar koeficientin prej 0,40, 2. Përvoja profesionale e shërbimeve të kompanisë të cilit i ka caktuar koeficient 0,20, 3. Përvoja profesionale e stafit (mesatarja e tërë stafit) të cilit i ka caktuar koeficient 0,20 si dhe 4. Metodologjia e realizimit të shërbimeve të cilit i ka caktuar koeficientin prej 0,20.**

*Në lidhje me nën kriteret 2 dhe 3*, Agjencia, konsideron se të njëjtat nën kriterë nuk mund të përdoren për dhënie të kontratës, pasi që nuk janë pajtim me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik. Autoriteti Kontraktues duhet të bëjë një dallim të qartë në mes kriterëve të përzgjedhjes dhe kriterëve për dhënie të kontratës. Sipas Legjislacionit në fuqi kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë si kriterë për dhënien e kontratës, andaj konsiderojmë se nën kriteret 2 dhe 3 të vendosura në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit janë caktuar si kriterë minimale për kualifikim ( kriterë të përzgjedhjes ). Në rastin konkret është kërkuar përvoja e Operatorit Ekonomik e dëshmuar me referenca dhe Stafi i kërkuar i Inxhinierëve me përvojë tek rubrika kapaciteti teknik/profesional, si kriterë minimale për kualifikim të Operatorëve Ekonomik.

Bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik (RRUOP) në nenin 26.5 parashihet se "Kriteret e përzgjedhjes në asnjë mënyrë nuk mund të përdoren si kriterë të dhënies së kontratës, ato nuk mund të kenë peshë të caktuar, ato janë kërkesa të vlerësimit kalon/nuk kalon".

Tutje në nenin 28 paragrafi 3 të RRUOP parashihet se " Nëse kriter për dhënie të kontratës është Tenderi ekonomikisht më i favorshëm, kontrata duhet t'i jepet tenderit i cili më së miri përmbush kriteret relevante. Përveç çmimit Autoriteti Kontraktues mund të përfshijë kriterë tjera relevante për lëndën e kontratës. Për shembull, mund të përfshihen: Karakteristikat e cilësisë, kostot operative, të mirëmbajtjes dhe kosto tjera të jetë-gjatësisë, karakteristika funksionale, teknike, mjedisore, estetike ose të ngjashme, shërbimi i pas-shitjes dhe asistencës teknike ".

Neni 28 Paragrafi 10 të RRUOP parasheh se “Duhet pasur kujdes për të siguruar që kriteret minimale për kualifikim (kriteret e përzgjedhjes) nuk përdorën si kritere në procesin e dhënies së kontratës. Tenderuesit do të konsiderohen të kenë përmbushur kërkesat minimale në lidhje me kapacitetin e tyre për të performuar kontratën që do të thotë që kriteret në lidhje me përvojat paraprake dhe historikut të kompanisë nuk do të shihen si kritere në procesin e dhënies së kontratës”.

Autoriteti Kontraktues duhet të ketë kujdes që në rast se përcaktohet për këtë kriter për dhënie të kontratës të caktoj nën kritere të qarta, precize, të matshme dhe të cilat kritere janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi që e rregullon fushën e prokurimit publik.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenin 26 Kriteret e Përzgjedhjes dhe nenin 28 Kriteret për dhënie të kontratës të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të mos i përsërisë praktikatat e tilla në të ardhmen.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

*Me respekt !*